

THE USE OF SPANISH NEWSPAPERS AS A DIDACTIC MATERIAL TO IDENTIFY STEREOTYPES OVER ALBANIA AND ALBANIANS

Mimoza Puto

University of Tirana, Faculty of Foreign Languages, Tirana, Albania, mimozaputo@yahoo.com

Abstract: The use of communication and information technologies has created a new reality in the education system, bringing about important changes in both teaching and learning processes. My study aims to show that through new technologies we can use easily accessible newspapers' online archives and try to understand the way Spanish media has built various stereotypes on Albanian and Albanians. In this way, while through the study of the Spanish language the students develop their linguistic communication capacities, which makes possible the deciphering of the message, at the same time they develop other cultural, social and civil competences. Taking into account that the texts are about their country, it is easier for them to capture and interpret in the right way the content of the journalistic text, which is written in a rich language, but to take also a critical stance to the clichés produced by it. At the same time, they come to know about the concept of the historical memory and the cognition process. They learn how to study stories of the past, the creation of stereotypes that are part of our everyday lives and the way they condition the public opinion. We can better orient students on how to develop their digital competencies through the use of the technology during their learning process, which more concretely means to consult newspapers online archives to finding and spotting texts conveying stereotyped messages over Albania and Albanians. The use of internet overcomes geographic barriers and makes possible a free and direct access to the authentic information sources, at any time and without intermediaries. The use of communication and information technologies is a strong and motivating stimuli for the students to increasing their capabilities to work in an independent and interactive way. At the same time, students learn to consider mass media in general, and the written press in particular, as important sources of information which very much influence over the image-building processes, and also to the diffusion of prejudices and stereotypes through it. We have different stereotypes based on different characteristics such as ethnicity, social class, age, gender, religion, etc. The current study is based upon using the online archives of the most important Spanish newspapers such as *El País*, *ABC*, *La Vanguardia*, Spanish News Agency *EFE*, etc. In their articles, Albanians are mostly identified as poor people, Mafiosi, corrupted and an emigrant nation, while Albania, eagle's country, as a former communist country with a heavy legacy of a ferocious dictatorship of Enver Hoxha, the most isolated former communist country in Europe, a former atheist country, and during the post-communist transition period to democracy as a country with dominant Muslim population.

Keywords: newspapers, Albania, stereotypes, Spanish

PËRDORIMI I GAZETAVE SPANJOLLE SI MATERIAL DIDAKTIK PËR TË IDENTIFIKUAR STEREOTIPET SHQIPTARE

Mimoza Puto

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tirana, Shqipëri, mimozaputo@yahoo.com

Abstrakti: Përdorimi i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIC, sipas siglave në anglisht) ka krijuar një realitet të ri në sistemin edukativ, duke sjellë ndryshime të rëndësishme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky punim synon që me anë të teknologjive të reja të përdorim gazetave on line, arkivi i të cilave është lehtësisht i aksesuesëm në internet, për të mësuar se çfarë stereotipesh ka përdorur shtypi spanjoll për Shqipërinë dhe shqiptarët. Në këtë mënyrë studentët krahas mësimit të gjuhës spanjolle dhe zhvillimit të kompetencës së komunikimit linguistik, që bën të mundur kuptimin e mesazhit, zhvillojnë dhe kompetenca të tjera si atë kulturore dhe sociale e qytetare. Duke qenë se flitet për vendin e tyre, ata e kanë më të lehtë për ta kuptuar dhe interpretuar drejt përmbajtjen e tekstit gazetares, i cili përmban një leksik të pasur, si dhe të mbajnë një qëndrim kritik ndaj këtyre klisheve. Në të njëjtën kohë, ata njihen dhe me konceptin e memories historike dhe konjitivizmin dhe mësojnë se si historitë e së kaluarës ndikojnë në formimin e stereotipeve që janë të pranishme dhe në ditët e sotme dhe kushtëzojnë opinionin publik. Duke hyrë në arkivat on line të gazetave nëpërmjet internetit për të gjetur tekste mbi Shqipërinë dhe identifikuar stereotipet për të, arrijmë t'i orientojmë studentët se si të ushtrojnë kompetencën digjitale duke përdorur teknologjinë në funksion të mësimnxënies. Interneti eliminon barrierat gjeografike dhe u mundëson studentëve të kenë akses të drejtpërdrejtë dhe në çdo kohë në burimet autentike pa ndërmyjetës. Përdorimi i TIC dhe i internetit i motivon dhe i stimulon studentët

për të mësuar, analizuar, investiguar, si dhe rrit aftësinë e tyre për të punuar në mënyrë të pavarur dhe interaktive. Po kështu, studentët mësojnë se si mediat e komunikimit masiv në përgjithësi dhe shtypi në veçanti, janë burim i rëndësishëm informacioni dhe ndikojnë në procesin e krijimit të imazhit të një vendi tjetër si dhe në përhapjen e paragjyqimeve dhe stereotipeve për të. Stereotipet janë të kategorive të ndryshme dhe lidhen me etninë, klasën shoqërore, fenë, gjininë, etj. Për të realizuar këtë punim janë përdorur arkivat on line të disa prej gazetave të rëndësishme spanjolle si *El País*, *ABC*, *La Vanguardia*, Agjencia spanjolle e Lajmeve, *EFE*, etj. Në shkrimet e tyre, shqiptarët identifikohen si të varfër, mafiozë, të korruptuar dhe popull emigrant, kurse Shqipëria, si vendi i shqiptonjave, një vend ish komunist me një diktaturë të egër të Enver Hoxhës, vendi i bunkerëve, vendi ish komunist më i izoluar në Evropë, ateist, dhe në demokraci si vend me shumicë të popullsisë myslimane.

Fjalët kyçe: gazeta, Albania, stereotip, spanjoll

HYRJE

Në shoqërinë e sotme njerëzore roli i medias është shumë i rëndësishëm, aq sa ka arritur të quhet dhe “shoqëri e informacionit”. Krijimi i mjeteve të komunikimit masiv ishte një revolucion në historinë e njerëzimit, duke e kthyer median në pushtetin e katërt, pas atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Por edhe vet mënyra jonë e jetesës, nuk mund të mendohet pa mediat, ku një rol të rëndësishëm luan shtypi. Përdorimi masiv i internetit ka bërë që gazetat të jenë të aksesueshme nga të gjithë që kanë dëshirë të informohen për ngjarje të ndryshme që ndodhin në botë. Pra, interneti ka eliminuar distancat dhe u ka dhënë mundësi njerëzve të informohen në kohë rekord për ngjarje që ndodhin në vende të ndryshme të botës mjafton që në dorë të kenë një aparat celular, një tabletë, ose një kompjuter. Mediat dhe shoqëria janë në një ndërveprim të vazhdueshëm dhe ndikimi tek njera-tjera është aq i madh sa që nuk mund të konceptohen pa njera-tjetrën³².

Përveç teorisë së shtypi, si pjesë e mediave, shërben vetëm si burim informacioni, ekzistojnë dhe teori të tjera të cilat pohojnë se mediat nuk janë thjesht riprodhuese të realitetit ekzistues, por dhe e ndërtojnë në një farë mënyre këtë realitet.

Imazhi i një vendi krijohet mbi ngjarjet historike dhe stereotipet apo klishetë që burojnë nga këto ngjarje. Në shoqërinë e sotme të informacionit, mjetet e komunikimit masiv luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e stereotipeve, paragjyqimeve dhe imazhit që publiku ose njerëzit në përgjithësi kanë për një person publik, për një grup apo klasë shoqërore të caktuar. Kështu, sipas Carlos Sotelo Enríquez “... tërësia e dijeve që zotëron shtresa e mesme në shoqëritë demokratike shndërrohet në një repertor stereotipesh që merr nëpërmjet mjeteve të komunikimit dhe nga marrëdhënia direkte me anëtarët e organizatës së cilës i përket”³³

Fjalori i Gjuhës Shqipe i botuar nga Akademia e Shkencave e shpjegon stereotipin, në kuptimin e tretë të saj, si diçka që përsëritet vazhdimisht pa asnjë ndryshim duke dhënë si sinonim fjalët: shabllon, standard³⁴. Fjala stereotip është huazim në gjuhën shqipe, prandaj u konsultova gjithashtu dhe me Fjalorin e Gjuhës Spanjolle të Akademisë Mbretërore, që shpjegon se stereotipi është “imazhi ose idea me karakter të pandryshueshëm, e pranuar gjerësisht nga një grup ose shoqëri”³⁵.

Elementet themelore të stereotipit janë thjeshtësi dhe përgjithësimi i diçkaje si dhe ekzistenca në mendje e një klisheje, e një ideje fikse të caktuar më parë.

Duke mos patur kohë të mjaftueshme për të njohur me themel tjetrin, ne “kufizohemi të dallojmë tiparet karakteristike të prototipeve që i njohim dhe të plotësojmë pjesën tjetër të imazhit duke kërkuar ndihmën e stereotipeve që gjenden me shumicë në mendjen tonë”³⁶.

Ne, shqiptarët, i identifikojmë spanjollët si të nxehtë, emocionalë, zeshkanë, të shkurtër e me flokë të zinj, që nuk u pëlqen puna por argëtimi dhe muzika. Kurse Spanjën e identifikojmë si vendi i demave, i flamenkos, i futbollit, i festave dhe i diskotekave. Po ashtu Spanja për ne, ashtu si dhe për evropianët, është vendi ideal për pushime, vend me diell dhe plazhe të bukura ku pihet sangría dhe halet paella.

Po cili është imazhi që shtypi spanjoll ka transmetuar tek lexuesi spanjoll për ne shqiptarët dhe Shqipërinë?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje do t'u drejtohem disa prej gazetave kryesore spanjolle, si *El País*, *ABC*, *La Vanguardia*, etj., arkivat e të cilave janë të disponueshme në internet dhe përbëjnë bazën materiale didaktike që do të përdorim në klasë.

³² McQuail, Denis. *McQuail's Mass Communication Theory*. London. Sage Publication. fq. 81

³³ Sotelo, Carlos, *Introducción a la comunicación institucional*, Barcelona, Ariel, 2001, fq. 92

³⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Fjalor i Shqipes së Sotme*. Tiranë. Toena. 2002, fq. 1206

³⁵ Real Academia Española. *Diccionario de la Lengua Española*. 2014. <http://dle.rae.es/?id=GqSjqfE>

³⁶ Lippmann, Walter. *La opinión pública*. Madrid. Cuadernos de Langré, 2003. F. 87.

VENDI I SHQIPONJAVE

Shqipëria apo Albania, në spanjisht, identifikohet si vendi i shqiponjave nëpër faqet e shtypit spanjoll. Këtë term e gjejmë të përdoret në artikujt e shkruar që pas rënies së komunizmit, në fillimvitet 1990 e deri në ditët e sotme. Kështu gazeta ABC në mars të 1990 në artikullin me titull: “Shqipëria, kufiri i fundit” shkruan: “Si mund të mendonin trashëgimtarët e Enver Hoxhës se vendi i tyre i vogël i shqiponjave do të qendronte larg ndryshimeve që po ndodhin në Europë?”³⁷.

Kurse nobelisti Mario Vargas Llosa, për artikullin e tij mbi Shqipërinë të shkruar në El País në kohën e revoltave popullore të shkaktuara nga falimentimi i skemave piramidale në mars të vitit 1997 ka zgjedhur titullin: “Vendi i shqiponjave”. Në të shkruan: “Tragedia e Shqipërisë, ky “vend i lashtë i shqiponjave”, nuk filloi me mashtrimin e bankave piramidale. Ajo që po shohim sot nuk është gjë tjetër veçse shpërthimi i një puçre me qelb të grumbulluar prej dekadash despotizmi dhe shtypjeje”³⁸. Po kjo gazetë në tetor të 2017-ës në suplementin kulturor “El viajero” i dedikon një artikull të gjatë turizmit shqiptar duke e titulluar: “Në rrugëtimin për në vendin e shqiponjave”³⁹.

VENDI VARFËR ME NJË SHOQËRI PRIMITIVE

Shqipëria identifikohet në shtypin spanjoll si vend i varfër. Por nëse pas rënies së komunizmit shkruhej për një vend ku të huajt nëpërmjet misioneve humanitare përipiqeshin “të zbusnin urinë”, në vitet e mëvonshme predominon termi Shqipëria, “vendi më i varfër i Evropës”, ose një nga më të varfërit e Evropës”. Kështu El País e krahason me Etiopinë Shqipërinë e sapodalë nga periudha e gjatë dhe e mundimshme komuniste. Në artikullin me titull: “Etiopi” në Europë” duke folur për kafshët që therreshin për mish në mes të rrugës ajo thotë: “Asnjë udhëtarë nuk tentohet nga një mall si mishi kaq i rrallë në Shqipërinë e re tashmë demokratike, por të varfër dhe të prapambetur si një Etiopi në Evropë”⁴⁰. Shtypi i asaj kohe pasqyron anarkinë e atyre viteve kur shqiptarët sulmonin dyqanet dhe magazinat për të siguruar ushqim duke sakrifikuar dhe jetën e tyre. Kurse La Vanguardia duke folur për krizën e refugjatëve kosovarë të strehuar në Shqipëri gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë në 1999 theksonte se “Vendi më i varfër i Europës duhet t’i bëjë ballë një prej tragjediave më të mëdha që ka njohur kontinenti pas Luftës së Dytë Botërore”⁴¹. Po kështu në një artikull të 2017 për turizmin malor të agjencisë së lajmeve Efe, të botuar në ABC, bie në sy një fjali e një malësori, i cili thotë: “Jetojmë në vendin më të bukur të botës, por ndoshta dhe në më të varfërin”⁴². Edhe pse Shqipëria ka bërë progres dhe ka aktualisht një ekonomi më të zhvilluar përsëri ajo mbetet një vend me të ardhura të ulëta për frymë prej 3.700 eurosh kundrejt 25.000 eurove që është në Spanjë.⁴³ Ato nënvizojnë faktin se shumica e të ardhurave familjare sigurohet nga paratë që dërgojnë emigrantët në shtëpitë e tyre si dhe nga ekonomia informale kriminale e drogës dhe e trafikeve të qenieve njerëzore.

Një stereotip tjetër është ai i një shoqërie primitive klanore ku nderi i familjes vazhdon të kushtëzojë jetën e komunitetit dhe kur shkelet ai atëhere merret gjak, pavarësisht kohës që ka kaluar. Ato e konsiderojnë gjakmarrjen si një formë primitive klanore të zgjidhjes së konflikteve, që popujt e tjerë ballkanikë kanë kohë që e kanë braktisur dhe nuk e praktikojnë më. Ky zakon i vjetër për të “bërë drejtësi” vjen nga kanuni i shekullit XV i Lekë Dukagjinit, një princi lokal verior ku thuhet se “gjaku lahet me gjak”. Ky “rit absurd”, kjo “mbeturinë mesjetare” e përhapur sidomos në veriun tradicional po frenon zhvillimin dhe modernizimin e shoqërisë dhe po përligj vrasjet e armiqve⁴⁴.

VEND ISH KOMUNIST QË U UDHËHOQ NGA DIKTATORI STALINIST ENVER HOXHA

³⁷ Pastrano, Fernando. *Albania, la última frontera*. ABC. 15.07.1990.

<http://hemeroteca.abc.es/nav/Navigate.exe/hemeroteca/madrid/blanco.y.negro/1990/07/15/025.html>

³⁸ Vargas Llosa, Mario. *El país de las águilas*. El País. 23.03.1997

https://elpais.com/diario/1997/03/23/opinion/859071603_850215.html

³⁹ Elorza, Antonio. *En ruta por el país de las águilas*. El País. 12.10.2017.

https://elviajero.elpais.com/elviajero/2017/10/12/actualidad/1507802464_184686.html

⁴⁰ Tertsch, Hermann. “*Etiopía*” en *Europa*”. El País, 31.03.1992

https://elpais.com/diario/1992/03/31/internacional/701992816_850215.html

⁴¹ Juliana, Enric. *Albania encaja, sin apenas ayuda, el éxodo y el dolor de millares de civiles kosovares*. La Vanguardia. 13.05.1999. <http://hemeroteca.lavanguardia.com/preview/1999/05/13/pagina/34467921/pdf.html?search=Albania>

⁴² Dhima, Mimoza. *La belleza escondida de las montañas albanesas*, EFE, ABC. 19.08.2017

http://www.abc.es/viajar/destinos/europa/abci-belleza-escondida-montanas-albanesas-201708101134_noticia.html

⁴³ Extensión. <https://www.datosmacro.com/paises/comparar/albania/espana>

⁴⁴ Zuccalá, Emanuela. *Los albaneses sufren de venganza de sangre*. El País. 7 shtator 2016.

https://elpais.com/elpais/2016/09/06/planeta_futuro/1473169002_327399.html

Në shumë artikuj emri “Albania” është i lidhur ngushtë me të kaluarën e saj komuniste. Janë të shpeshta shprehjet: “parajsë e komunizmit”, “bastion mitik komunist”, “rezervë shpirtërore” e markizëm leninizmit, “vend i vogël ish komunist”, “viktimë e një prej diktaturave më të egra, hermetike dhe mizore të shek. XX, të vendosur nga Enver Hoxha më 1945”⁴⁵.

Enver Hoxha përcaktohet, midis të tjerash, si “diktator stalinist”, “diktatori më i egër i Europës së pasluftës”, “paranoiak”, “shkatërrimtar i kishave dhe i xhamive”, “despoti shqiptar”, “lideri suprem”, “Timonieri i Madh”, një nga “tiranët më të frikshëm” që e izoloi vendin jo vetëm nga blloku komunist, por nga e gjithë bota”, krijues i “laboratorit të frikës”.

Gjatë një periudhe gati gjysëm shekullore, 1945-1991, Shqipëria ishte një vend i “izoluuar, i blinduar, paranoiak, dhe pa Zot me Kushtetutë; ku çdo komshi ishte spiun dhe i dyshimtë; pa makina, telefona, pa informacion tjetër, përveç propagandës. Nuk kishte pronë private, as jetë private. Me stërvitje ushtarake që në moshën 12 vjeçare”⁴⁶.

Pra, Shqipëria komuniste shihet si vendi më i izoluar në Evropë dhe si vendi i vetëm ateist zyrtar në botë, ku fjala “Zot” nuk ekzistonte as në fjalor dhe ku burgosej dhe persekutohej çdo njeri që propagandonte fenë dhe shpërndante literaturë fetare. Në vitin 1967 në Shqipëri u ndërmorr një fushatë e ashpër kundër fesë, në kuadër të Revolucionit Kulturor kinez, e cila përfundoi me shkatërrimin e qindra kishave, xhamive, teqeve dhe ato që mbetën u kthyen në pallat sporti, magazina, qendra kulture, etj. Nën titullin: “Një katedrale e kthyer në fushë basketbolli”, ABC shkruan se qyteti i Shkodrës, ku u ruajt katolicizmi dhe në periudhën osmane, “u caktua nga autoritetet komuniste si kryeqyteti botëror i ateizmit dhe për ta vërtetuar këtë përfshinin në “turin” turistik një vizitë të detyruar në muzeun e vetëm kushtuar ateizmit në të gjithë planetin”⁴⁷.

Kur flitet për Shqipërinë postkomuniste ajo konsiderohet si një vend me shumicën e popullsisë myslimane, por dhe si “bastion i tolerancës fetare” ku komunitetet fetare bashkëjetojnë në paqe me njeri tjetrin. Shqipëria si vend i harmonisë fetare spikat sidomos në shkrimet kushtuar vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri në vitin 2014.

Nga ana tjetër, disa gazeta e paraqesin atë si burim të radikalizmit islamik duke theksuar faktin se shumë shqiptarë kanë shkuar në Siri për të luftuar për Shtetin Islamik.

Shqipëria vazhdon të mbetet për shtypin spanjoll “një nga vendet më të izoluar të Europës” dhe jashtë hartës së saj aq sa as refugjatët sirianë nuk e përdorën për të kaluar në Gjermani gjatë krizës së vitit 2015.

Ajo identifikohet gjithashtu si vendi i bunkerëve, një trashëgimi e “liderit suprem” i cili ndërtoi mijëra të tillë gjatë viteve 1970-1980 në çdo cep të vendit për t’u mbrojtur nga një sulm i mundshëm “imperialistorevizionist”, që nuk ndodhi kurrë. Ato vënë theksin se aktualisht këta bunkerë janë kthyer në atraksion turistik për vendin që kanë ngjallur kuriozitetin e të huajve. Kështu One Magazine ka zgjedhur t’i habitë lexuesit e saj duke zgjedhur për titull të një artikulli të saj: “Vendi më turistik në Shqipëri është... një bunker i Luftës së Ftohtë!”⁴⁸. Artikulli i kushtohet një bunkerit gjigand të zbuluar kohët e fundit, i cili ndodhet i fshehur pesë kate nën tokë në malin e Dajtit, pranë Tiranës, i cili u ndërtua nga fundi i viteve 1970 për të strehuar shtabin e ushtrisë në kohë lufte. Kurse gazeta El Correo. pasi e krahason Shqipërinë komuniste me Korenë e Veriut të Evropës, thekson se është e mbushur me bunkerë. Ka rreth 750.000 deri në një milion, pra rreth 26 për km katrorë, ose një për çdo tre shqiptarë⁴⁹.

SHQIPTARËT MAFIOZË E TRAFIKANTË

Pas rënies së komunizmit dhe hapjes së kufijve, një e treta e tre milion shqiptarëve e braktisën vendin dhe ikën jashtë në kërkim të një jete më të mirë. Kurse një pjesë, e etur për një pasurim të shpejtë u mor me aktivitete të paligjshme si droga, krimi e trafikimi i qenieve njerëzore. “Në vend lulëzuan plantacionet e marihuanës, mafia e narkotrafikut dhe krimi i organizuar shtriu tentakulat në gjysmën e Europës”⁵⁰. Kurse ABC shkon deri atje sa t’i

⁴⁵ Val, Eusebio. *Francisco rechaza los argumentos del yihadismo*, La Vanguardia. 22. 09.2014

<http://hemeroteca.lavanguardia.com/preview/1999/05/13/pagina/94396499/pdf.html?search=Albania>

⁴⁶ Rodríguez, Jesús, *El patio trasero de Europa*. El País Semanal. 16.03.2008

https://elpais.com/diario/2008/03/16/eps/1205652413_850215.html

⁴⁷ *Una catedral convertida en cancha de baloncesto*. ABC. 14.01. 1990.

<http://hemeroteca.abc.es/nav/Navigate.exe/hemeroteca/madrid/abc/1990/01/14/038.html>

⁴⁸ “*El lugar más turístico de Albania es... ¡un búnker de la Guerra Fría!*”. One Magazine. 28.11. 2014.

<http://www.onemagazine.es/noticia/20552/ocio/el-lugar-mas-turistico-de-albania-es...-un-bunker-de-la-guerra-fria.html>

⁴⁹ López, Luis. *Sexo en el búnker*. El Correo. 8.09.2015. <http://www.elcorreo.com/bizkaia/internacional/union-europea/201509/08/sexo-bunker-20150901124231.html>

⁵⁰ Xaxás, Javier Más de. *Malcolm X en Tirana*. La Vanguardia. 18.04.1999.

<http://hemeroteca.lavanguardia.com/preview/1999/04/18/pagina6/96856041/pdf.html?search=Albania>

quajë shqiptarët si “populli që u mësoi italianëve artin e mafias”⁵¹ Ndërkohë në dhjetëvjeçarin e fundit ato pasqyrojnë gjerësisht lajme që flasin për bandat shqiptare që grabisin shtëpitë e të pasurve në Spanjë dhe që vriten mes tyre për të kontrolluar zonat e influencës së drogës dhe prostitucionit.

KONKLUZIONE

Në shtypin spanjoll ka predominuar një imazh negativ për Shqipërinë dhe shqiptarët, që lidhet me ngjarjet politiko-shoqërore që kanë lënë gjurmë në historinë e vendit tonë. Edhe pse Shqipëria është tani vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe po kthehet në një destinacion të preferuar turistik në Evropë, stereotipet negative për të janë të qëndrueshme dhe të vështira për t'u çrrënjësuar. Në disa raste ato nuk i përgjigjen realitetit, gjë që duket dhe nga opinionet e turistëve spanjollë që vizitojnë vendin tonë. Shumica e tyre, vijnë me paragjykime dhe largohen me përshtypje të mira nga Shqipëria duke e parë atë si vend të sigurt, me natyrë të bukur, njerëz të dashur e ushqim të mirë, sipas anketave të kryera nga agjencitë turistike vendase. Përdorimi i shtypit on line si mjet didaktik në klasë është i dobishëm pasi i njuh studentët me imazhin që ai përcjell tek lexuesit për një vend të caktuar dhe nxit debatin rreth kësaj teme.

REFERENCES

- [1] Akademia e Shkencave e Shqipërisë. *Fjalor i Shqipes së Sotme*. Tiranë. Toena. 2002
- [2] Dhima, Mimoza. *La belleza escondida de las montañas albanesas*, EFE, ABC. 19.08.2017
http://www.abc.es/viajar/destinos/europa/abci-belleza-escondida-montanas-albanesas-201708101134_noticia.html
- [3] “*El lugar más turístico de Albania es... ¡un búnker de la Guerra Fría!*”. One Magazine. 28.11. 2014.
<http://www.onemagazine.es/noticia/20552/ocio/el-lugar-mas-turistico-de-albania-es...-un-bunker-de-la-guerra-fria.html>
- [4] Elorza, Antonio. *En ruta por el país de las águilas*. El País. 12.10.2017.
https://elviajero.elpais.com/elviajero/2017/10/12/actualidad/1507802464_184686.html
- [5] Expansión. <https://www.datosmacro.com/paises/comparar/albania/espana>
- [6] Juliana, Enric. *Albania encaja, sin apenas ayuda, el éxodo y el dolor de millares de civiles kosovares*. La Vanguardia. 13.05.1999.
<http://hemeroteca.lavanguardia.com/preview/1999/05/13/pagina/34467921/pdf.html?search=Albania>
- [7] Lippmann, Walter. *La opinión pública*. Madrid. Cuadernos de Langré, 2003
- [8] López, Luis. *Sexo en el búnker*. El Correo. 8.09.2015.
<http://www.elcorreo.com/bizkaia/internacional/union-europea/201509/08/sexo-bunker-20150901124231.html>
- [9] McQuail, Denis. *McQuail's Mass Communication Theory*. London. Sage Publication
- [10] Pastrano, Fernando. *Albania, la última frontera*. ABC. 15.07.1990.
<http://hemeroteca.abc.es/nav/Navigate.exe/hemeroteca/madrid/blanco.y.negro/1990/07/15/025.html>
- [11] Real Academia Española. *Diccionario de la lengua Española*. 2014. <http://dle.rae.es/?id=GqSjqfE>
- [12] Rodríguez, Jesús, *El patio trasero de Europa*. El País Semanal. 16.03.2008
https://elpais.com/diario/2008/03/16/eps/1205652413_850215.html
- [13] Sotelo, Carlos, *Introducción a la comunicación institucional*, Barcelona, Ariel, 2001
- [14] Tertsch, Hermann. “*Etiopía*” en *Europa*”. El País, 31.03.1992
https://elpais.com/diario/1992/03/31/internacional/701992816_850215.html
- [15] *Una catedral convertida en cancha de baloncesto*. ABC. 14.01. 1990.
<http://hemeroteca.abc.es/nav/Navigate.exe/hemeroteca/madrid/abc/1990/01/14/038.html>
- [16] Val, Eusebio. *Francisco rechaza los argumentos del yihadismo*, La Vanguardia. 22. 09.2014
- [17] <http://hemeroteca.lavanguardia.com/preview/1999/05/13/pagina/94396499/pdf.html?search=Albania>
- [18] Vargas Llosa, Mario. *El país de las águilas*. El País. 23.03.1997
https://elpais.com/diario/1997/03/23/opinion/859071603_850215.html

⁵¹ Villapadierna, Ramiro. *La castigada Albania vota hoy desde el vértigo de un agujero sin fondo*. ABC. 22.03.1992.
<http://hemeroteca.abc.es/nav/Navigate.exe/hemeroteca/sevilla/abc.sevilla/1992/03/22/031.html>

- [19] Villapadierna, Ramiro. *La castigada Albania vota hoy desde el vértigo de un agujero sin fondo*. ABC. 22.03.1992.
<http://hemeroteca.abc.es/nav/Navigate.exe/hemeroteca/sevilla/abc.sevilla/1992/03/22/031.html>
- [20] Xaxás, Javier Más de. *Malcolm X en Tirana*. La Vanguardia. 18.04.1999.
<http://hemeroteca.lavanguardia.com/preview/1999/04/18/pagina6/96856041/pdf.html?search=Albania>
- [21] Zuccalá, Emanuela. *Los albaneses sufren de venganza de sangre*. El País. 7 shtator 2016.
https://elpais.com/elpais/2016/09/06/planeta_futuro/1473169002_327399.html